



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin

Dokument parlamentar

Tiranë, më 14.04.2020

RAPORT
PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 166,
DATË 16.12.2004 “RREGULLORJA E KUVENDIT TË SHQIPËRISË” TË
NDRYSHUAR”

I. Hyrje

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, në cilësinë e organit përgjegjës sipas nenit 13 të Rregullores, në mbledhjen e datës 14 prill 2020 mori në shqyrtim projektvendimin “Për disa shtesa në vendimin nr. 166, datë 16.12.2004 “Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë” të ndryshuar”, nismë e Kryetarit të Kuvendit e depozituar në Kuvend më 10.04.2020.

Mbledhja e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, për shkak të situatës së shkaktuar nga COVID-19 u zhvillua me anë të mjeteve të komunikimit elektronik. Kuvendi për të bërë të mundur zhvillimin e mbledhjeve on line ka instaluar aplikacionin Cisco Webex.

II. BAZA LIGJORE E PROPOZIMEVE PËR NDRYSHIME NË RREGULLOREN E KUVENDIT

Projektvendimi i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Kryetari i Kuvendit sipas përcaktimeve të nenit 117 të Rregullores së Kuvendit sipas së cilës *“Çdo deputet ka të drejtë të paraqesë propozime për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit. Për shqyrtimin e këtyre propozimeve ndiqet procedura e parashikuar në këtë Rregullore për paraqitjen dhe shqyrtimin e projektligjeve. Ndryshimet në këtë Rregullore miratohen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.dhe është shoqëruar me relacionin sipas përcaktimit të nenit 68 të Rregullores”*.

III. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT E TIJ

Qëllimi i këtij projektvendimi është parashikimi i zhvillimit të mbledhjeve të Kuvendit dhe organeve të tij nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik si videokonferencë, postë

elektronike, platforma *on line* me qëllim vijimin e veprimtarisë parlamentare edhe në rastet e vendosjes së masave të jashtëzakonshme të përcaktuara në nenin 170 të kushtetutës.

Propozimet vijnë në një moment kur Organizata Botërore e Shëndetësisë ka shpallur gjëndjen e pandemisë botërore, për shkak të përhapjes së infeksionit COVID -19. Ashtu si shumë vende të botës, edhe Shqipëria është pjesë listës së shteteve ku është përhapur ky infeksion. Si pasojë e kësaj, në vendin tonë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka shpallur gjëndjen e epidemisë. Për të parandaluar këtë situatë ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në zbatim të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si dhe në zbatim të udhëzimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë ka ndërmarrë një sërë masash, ndërmjet të cilave edhe anulimin e të gjitha grumbullimeve masive, në vende të mbyllura apo të hapura, si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike etj.

Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 243, datë 24.03.2020, ka shpallur gjëndjen e fatkeqësisë natyrore duke parashikuar njëkohësisht edhe masat që duhet të merren gjatë kohëzgjatjes së kësaj gjëndjeje nga institucionet publike, strukturat operationale të sistemit të shëndetësisë, subjektet private dhe shtetasit gjatë kohëzgjatjes së gjëndjes së jashtëzakonshme.

Organet kolegjiale, si organe të përbëra nga një numër i konsiderueshëm personash paraqesin rrezikshmëri të lartë në përhapjen e infeksionit në këtë situatë. Për këtë arsye një ndër masat e marra nga qeveria në aktin normativ me fuqinë e ligjit nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, është edhe marrja e vendimeve nga organet kolegjiale nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik, gjatë kohëzgjatjes së gjëndjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19. Kjo dispozitë shtrihet mbi organet kolegjiale të administratës shtetërore që ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekzekutive dhe nuk përfshin Kuvendin e Shqipërisë, organizimi dhe funksionimi i të cilit, në mbështetje të nenit 75, pika 2 të Kushtetutës, bëhet me anë të Rregullores së tij.

Kuvendi ka rolin kryesor në jetën politike të vendit dhe për pasojë rregullat mbi të cilat ai organizohet dhe funksionon duhet ti përgjigjen çfarëdolloj situatë në të cilën gjendet vendi. Mosndërprerja e punimeve parlamentare dhe vijimi i veprimtarisë së Kuvendit nëpërmjet instrumenteve të komunikimit elektronik bëhet detyrë imperative veçanërisht kur në kushtet e nevojës dhe urgjencës masat e ndërmarra me qëllim parandalimin dhe luftimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, por edhe paketa e masave ekonomike dhe sociale për lehtësimin dhe përballimin e efekteve të shkaktuara nga masat kufizuese të vendosura për luftimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 kërkon miratimin e Kuvendit brenda një afati të kufizuar kushtetues, 45 ditor.

Rregullorja e Kuvendit, parashikon se mbledhjet e Kuvendit ose të organeve të tij mund të zhvillohen në selinë e Kuvendit ose edhe jashtë selisë. Zhvillimi i mbledhjeve jashtë selisë nënkupton mbledhjen e anëtarëve të Kuvendit ose organit parlamentar në një tjetër vend ndryshe nga vendi i zakonshëm (selia). Ndonëse në Rregulloren e Kuvendit gjen përcaktim zhvillimi i mbledhjeve jashtë selisë nuk gjen përcaktim zhvillimi i mbledhjeve me anë të mjeteve të komunikimit elektronik.

Duke marrë shkas edhe nga eksperiencia e vendeve të tjera Kuvendi mund dhe duhet të aplikojë këtë metodë të re në zhvillimin e veprimtarisë së tij. Avancimi i teknologjisë në ditët e sotme ka bërë të mundur realizimin e komunikimit në distancë ku përveç zërit është i mundur edhe transmetimi i figurës. Ndërsa më parë kur flitej për videokonferencë, nënkuptoheshin pajisje të mëdha, të posaçme dhe të shtrenjta, që lejonin komunikimin audio dhe video të dy personave që nuk ndodheshin në të njëjtin vend, sot koncepti i videokonferencës ka ndryshuar në mënyrë rrënjësore duke folur për videokonferencë në desktop, pra në lap top, PC apo në celular. Falë

shërbimit të internetit, videokomunikimi është për të gjithë një mënyrë e përhapur për të komunikuar, duke kontribuar pozitivisht në situatën e krijuar por edhe në përmirësimin e cilësisë së punës dhe të jetës sonë të përditshme.

Neni 78, pika 2 e Kushtetutës parashikon shprehimisht se mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas Rregullores, nuk sjellin asnjë pasojë. Në këtë këndvështrim parashikimi ligjor për zhvillim të mbledhjeve me anë të mjeteve të komunikimit elektronik kërkon domosdoshmërisht amendimin e Rregullores së Kuvendit.

IV. PRAKTIKA E HUAJ PARLAMENTARE¹

Në situatën e krijuar, për të parandaluar përhapjen e Coronavirusit shumë vende kanë filluar të aplikojnë zhvillimin e mbledhjeve me anë të mjeteve të komunikimit elektronik. Parlamente të ndryshme kanë ndryshuar madje edhe procedurat parlamentare, të cilat shpesh kanë kërkuar edhe ndryshimin e rregullave të punës së parlamentit.

- Parlamenti estonez

Komisioni Parlamentar Kushtetues ka vendosur që mbledhjet e komisioneve parlamentare mund të zhvillohen duke përdorur formatin *teleworking* për mbledhjet e tyre. Aktualisht, nuk ka mundësi për të zhvilluar seanca plenare nëpërmjet përdorimit të video konferencë ose mjeteve të tjera nëpërmjet platformave online. Megjithatë, kjo çështje është ende në diskutim.

- Parlamenti kroat

Parlamenti kroat ka miratuar disa udhëzime për zhvillimin e punës në distancë sipas të cilave mbledhjet do të mbahen me anë të mjeteve elektronike apo telefonike.

- Parlamenti francez (senati)

Senati francez është duke përdorur një votim i zgjeruar (proxy voting), duke lejuar një senator që të votojë në seancën plenare për të gjithë anëtarët e grupit të tij/saj politik. Mbledhjet e Komisioneve Parlamentare organizohen me anë të *Tixeo technology* për video konferencë.

- Parlamenti i Luksemburg-ut

Rregullorja nuk përmend shprehimisht që deputetët duhet të jenë fizikisht të pranishëm në një ambient për të ushtruar detyrat e tyre legjislative. Për sa kohë ata mblidhen dhe kanë mundësinë të diskutojnë dhe të votojnë, prezenca fizike në një ambient të vetëm është një element që mund të anashkalohet. Pra mbledhjet e Komisioneve Parlamentare mund të organizohen në mënyrë elektronike, ndërsa mbledhjet në seancë plenare, nuk është e mundur të ushtrohet i njëjti parim, pasi seancat plenare kanë natyrë publike në Luksemburg.

- Parlamenti European

Rregullorja e Parlamentit Evropian nuk parashikon zhvillimin e mbledhjeve të komisioneve parlamentare dhe të seancës plenare me video konferencë. Megjithatë, Byroja e Parlamentit

¹ Referenca

▪ Faqja zyrtare e Qendrës Evropiane të Kërkimit Parlamentar dhe Dokumentacionit (ECPRD) <https://ecprd.secure.europarl.europa.eu> (aksesuar për herë të fundit më 02.04.2020)

Evropian me datë 20 mars 2020, bazuar në kompetencën e përcaktuar me Rregullore si organi përgjegjës për disiplinimin e çështjeve që lidhen me zhvillimin e mbledhjeve vendosi të ndryshojë rregullat në zhvillimin e punimeve të parlamentit Europian si vijon:

- Deputetët mund të zgjedhin të marrin pjesë në seancën e jashtëzakonshme plenare personalisht ose në distancë përmes mjeteve elektronike. Nëse ata vendosin të mos jenë të pranishëm, ata mund të votojnë në distancë me anë të postës elektronike të parlamentit, e cila konsiston në dërgimin e votës në kuti të dedikuar para përfundimit të afatit, ku fleta e votimit duhet e printuar, e plotësuar, e nënshkruar dhe skanuar ose fotografuar.
- Të gjitha votat merren përmes *roll- call*.
- E gjithë seanca parlamentare jepet përmes internetit.
- Të gjithë deputetët, përfshirë ata që janë të pranishëm në seancë votojnë në mënyrën e sipërpërmendur.

Në lidhje me zhvillimin e mbledhjeve në komisionet parlamentare, në përpjekje për të zvogëluar përhapjen e virusit Covid -19, Parlamenti ka zvogëluar nevojën për takime fizike në ambientet e tij, pa kompromentuar rolin e tij për një kontroll demokratik dhe as aftësinë e tij për të miratuar masat e nevojshme legjislative për të luftuar virusin dhe mbështetur publikun, konsumatorët, biznesin dhe shërbimin e urgjencës. Janë prezantuar një sërë masash për të lehtësuar pjesëmarrjen në distancë të eurodeputetëve në komisione parlamentare duke iu mundësuar dëgjimin, shikimin e punimeve të komisioneve, mundësinë për të kërkuar fjalën dhe mundësinë që të flasin gjatë mbledhjes. Votimi në distancë në komisione parlamentare është parashikuar edhe pse ai mund të jetë më i vështirë për t'u zbatuar për shkak të numrit të lartë të amendamenteve të akteve që bëhen në komisione parlamentare.

- **Parlamenti belg**

Në parlamentin belg më 26 Mars 2020 Dhoma e Përfaqësuesve amendoi rregulloren e saj për të lejuar pjesëmarrjen në distancë të anëtarëve të saj edhe pse nuk janë fizikisht prezent në Bruksel. Pjesëmarrja dhe votimi bëhet me mjete të komunikimit elektronik, postë elektronike. Këto masa janë marrë për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19. Aktualisht po përdoret aplikacioni "ZOOM".

Votimi në distancë në komisionet parlamentare të cilat zhvillojnë mbledhje me anë të videokonferencës, mund të kryhet me ngritje dore kështu që nuk ka qënë e nevojshme të kryhen me mjete të komunikimit elektronik. Për mbledhjet në seancën plenare ekziston versioni teorik i votimit verbal, por për momentin nuk është vënë në përdorim.

- **Parlamenti estonez**

Komisioni Kushtetues i Parlamentit të Estonisë ka vendosur më datë 16.03.2020 që mbledhjet e komisioneve parlamentare mund të përdorin formatin *teleworking* për mbledhjet e tyre. Aktualisht, nuk ka mundësi për të zhvilluar seanca plenare nëpërmjet përdorimit të video konferencë ose mjeteve të tjera nëpërmjet platformave online. Megjithatë, kjo çështje është ende në diskutim. Rregullorja e Parlamentit nuk ka rregullime specifike lidhur me organizimin e mbledhjeve të komisioneve parlamentare dhe të seancës plenare nëpërmjet platformave online.

- **Parlamenti francez**

Rregullorja e Senatit të parlamentit francez nuk parashikon votimin me mjete të komunikimit elektronik. Megjithatë Shërbimi Legjislativ i parlamentit francez po shqyrton mundësinë e amendimit të Rregullores për të mundësuar këtë lloj votimi, duke pasur parasysh problematikat e krijuara nga COVID-19. Opinioni i përgjithshëm është se duhet:

- Krijimi i mundësive për organizimin e seancave plenare në distancë pa të drejtë vote me anë të videokonferencave (diskutime, debate dhe dëgjesa)
- Ndalimi i çdo lloji votimi formal në distancë.

Sidoqoftë, parlamenti francez përdor një votim të zgjeruar (proxy voting), duke lejuar një senator që të votojë në seancën plenare për të gjithë anëtarët e grupit të tij/saj politik. Mbledhjet e komisioneve parlamentare organizohen me anë të *Tixeo technology* për video konferencë.

- **Parlamenti gjerman (Bundestag, Bundesrat)**

Rregullorja e Bundestag-ut nuk parashikon zhvillimin e seancës plenare me anë të përdorimit të video konferencës. Më datë 25.03.2020 Bundestagu ka ndryshuar përkohësisht Rregulloren e tij duke iu përshtatur situatës së krijuar nga COVID -19. Për mbledhjet e komisioneve parlamentare, pjesëmarrja në distancë e deputetëve është lejuar deri më datë 30.09.2020 (rregulli 126a) rregull që mund të shfuqizohet në çdo kohë nga Bundestagu.

Rregulli 126a parashikon sa vijon:

- Uljen e kuorumit në 25 % të deputetëve (për komisionet parlamentare dhe seancën plenare);
- Zgjerimin e mundësisë së deputetëve për të përdorur procedurat me shkrim;
- Lejimin e pjesëmarrjes në distancë të deputetëve për mbledhjet e komisioneve parlamentare;
- Kufizimin lidhur me qasjen në dëgjesa publike ose mbledhje komisioni;

Neni 46 (3) i Kushtetutës së Gjermanisë kërkon miratimin nga Bundestagu në rast kufizimi të lirisë personale të deputetit. Kjo përfshin masat sipas ligjit “Për mbrojtjen nga infeksionet”.

Nëpërmjet ndryshimit të Aneksit 6 të Rregullores së Bundestag dhe duke vendosur pikën 6a, zbatimi i masave në bazë të ligjit “Për mbrojtjen nga infeksionet” tek deputetët u morën në mënyrë të tillë që të merreshin me situatën e krijuar nga Covid-19.

Pika 6a ka përmbajtje si vijon: “Bundestagu gjerman autorizon masat mbrojtëse në bazë të ligjit “Për mbrojtjen nga infeksionet” duke kufizuar lirinë e deputetëve të tij. Autoriteteve përgjegjëse iu kërkohet të njoftojnë pa vonesë Kryetarin e Bundestag-ut për masat e marra ndaj një deputeti. Komisioni parlamentar për Mbikëqyrjen e Zgjedhjeve, Imunitetin dhe Rregulloren ka të drejtë të verifikojë nëse masat e marra janë në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen nga infeksioni” dhe nëse ndonjë prej tyre dëmton padrejtësisht aftësinë operacionale të Bundestag-ut. Nëse Komisioni, konstaton një gjë të tillë mundet që me anë të një vendimi paraprak të kërkojë pezullimin e masave të marra. Nëse Komisioni, nuk është në gjendje të mblidhet brenda dy ditëve nga marrja e njoftimit të autoritetit përgjegjës, atributet e tij i merr Kryetari i Bundestag. Në të gjitha aspektet e tjera, deputetët nuk pengohen nga masa të përgjithshme në bazë të ligjit “Për parandalimin nga infeksioni” siç është kufizimi i detyrueshëm nga ushtrimi i mandatit të tyre dhe veçanërisht nga udhëtimi në seancë plenare dhe mbledhje të Bundestag.

- **Parlamenti izraelit**

Në rastin e Izraelit, në mënyrë që të zhvillohen seancat plenare apo mbledhjet e komisioneve parlamentare është e rëndësishme që deputetët të jenë prezent fizikisht gjatë zhvillimit të tyre. Kjo parashikohet në nenin 11 të ligjit themeltar të Knesset sipas së cilit “Seancat plenare të Knesset zhvillohen në ambientet e tij. Kur kjo është e pamundur Kryetari i Knesset së bashku me zëvendëskryetarët mund të vendosin që mbledhja të organizohet në një vend tjetër” dhe Seksioni 111 i Rregullores së Knesset sipas së cilit “Mbledhjet e Komisioneve të Knesset zhvillohen në ambientet e tij. Në raste të veçanta dhe me lejen paraprake të Kryetarit të Parlamentit, ato mund të mbahen në një vend tjetër.”

Duke mbajtur parasysh situatën shëndetësore emergjente të krijuar, Knesset në përputhje edhe me udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë të Izraelit po zbaton masat e mëposhtme:

Seanca plenare - Gjatë debateve jo më shumë se 10 persona do të jenë prezent gjatë diskutimit, duke përfshirë këtu Kryetarin e Parlamentit, Sekretarin e Përgjithshëm, një asistent, një person përgjegjës për transkriptimet dhe jo më shumë se 6 anëtarë të Knesset. Distanca mes pjesëmarrësve nuk duhet të jetë më e vogël se 2 metra. Anëtarët e Knesset firmosin paraprakisht për marrjen e fjalës dhe thirren me rradhë për të marrë fjalën. Mbledhja do të transmetohet live me anë të ekraneve të vendosura në të gjithë ambientet e pritjes. Anëtarët do të thirren në rend alfabetik për të votuar.

Komisionet Parlamentare - Mbledhja e Komisioneve do të organizohet në të njëjtën kohë në dy ambiente të ndara dhe të veçuar nga njëri-tjetri, me lidhje audio-video ndërmjet tyre. Kjo masë merret për të realizuar distancimin social dhe për të kufizuar sa më shumë të jetë e mundur numrin e personave në secilën prej ambienteve.

- Parlamenti kroat

Rregullorja e parlamentit kroat nuk parashikon shprehimisht rastet e punës në distancë. Megjithatë për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, kryesia e parlamentit ka miratuar disa udhëzime për punën në distancë. Udhëzimet parashikojnë orarin dhe axhendën e punës së parlamentit. Mbledhjet do të mbahen me anë të mjeteve të komunikimit elektronik. Udhëzimet do të jenë në fuqi deri në momentin që do të mbarojë pandemia globale e krijuar nga ky virus. Më pas puna e parlamentit do të rikthehet në normalitet.

- Parlamenti lituanez

Rregullorja e parlamentit të Lituaniës përpara situatës së krijuar nga COVID-19, nuk parashikonte zhvillimin e mbledhjeve të komisioneve parlamentare dhe të seancës plenare me video konferencë apo platformave të tjera online. Për shkak të zhvillimeve të fundit, Parlamenti ka vendosur të ndryshojë statutin e tij duke lejuar komisionet parlamentare për të zhvilluar mbledhjet në distancë përmes mjeteve të teknologjisë. Për këtë arsye komisionet parlamentare janë duke përdorur “Microsoft teams” software. Mbledhjet e Byrosë gjithashtu zhvillohen në distancë.

- Parlamenti i Luksemburgut

Rregullorja e Dhomës së Deputetëve gjithashtu nuk parashikon në mënyrë specifike votimin/organizimin e punës së parlamentit në distancë. Megjithatë interpretimi i zgjeruar i dispozitave të Rregullores lidhur me mbledhjet e komisioneve dhe votimin mund të interpretohen në mënyrë të tillë që mund të realizohen edhe me videokonferencë. Sipas Rregullores nuk përmendet shprehimisht që deputetët duhet të jenë fizikisht prezent në një ambient për të ushtruar detyrat e tyre legjislativë. Për sa kohë ata mblidhen dhe kanë mundësinë të diskutojnë dhe të votojnë, prezenca fizike në një ambient të vetëm është një element që mund të anashkalohet. Pra mbledhjet e komisioneve parlamentare mund të organizohen me anë të mjeteve të komunikimit elektronik në kundërshtim me mbledhjet në seancë plenare, për të cilat nuk është e mundur të ushtrohet i njëjti parim, pasi seancat plenare kanë natyrë publike në Luksemburg.

- Parlamenti Sllovak

Rregullorja e parlamentit të Sllovakisë nuk lejon zhvillimin e mbledhjeve të komisioneve parlamentare dhe të seancës plenare me video konferencë apo me mjete të tjera. Sipas nenit 36 paragrafi 5 i Rregullores, deputetët votojnë nga vendet e përcaktuara për ta. Parlamenti i Sllovakisë nuk e ka ndryshuar Rregulloren e tij për t’iu përshtatur masave të marra në kuadër të COVID -19 dhe nuk planifikon t’u ndryshojë atë.

Duke marrë shkas edhe nga eksperiencia e vendeve të tjera Kuvendi mund dhe duhet të aplikojë këtë metodë të re në zhvillimin e veprimtarisë së tij. Kuvendi është i vetmi organ përfaqësues i qytetarëve dhe si i tillë duhet të vazhdojë ti përfaqësojë dhe mbrojë ata.

V. DREJTIMET KU KONSISTOJNË PROPOZIMET

Projektvendimi i propozuar plotëson boshllëkun në dispozitat aktuale të Rregullores së Kuvendit. Këto plotësime konsistojnë në drejtimet e mëposhtme:

- **Në lidhje me mënyrën e zhvillimit të mbledhjeve të Kuvendit dhe organeve të tij në rastet e masave të jashtëzakonshme**

Në raste të masave të jashtëzakonshme që mund të vendosen për shkak të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësive natyrore, mbledhjet e seancës plenare dhe organeve të Kuvendit mund të zhvillohen edhe në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik

Seanca plenare, mund të mbledhet edhe fizikisht me numër të reduktuar të deputetëve.

Zhvillimi në distancë, nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik, i mbledhjeve të Konferencës së Kryetarëve, Byrosë së Kuvendit dhe Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin parashikohet të jetë kompetencë e Kryetarit të Kuvendit, ndërsa zhvillimi në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik të komisioneve parlamentare si dhe zhvillimi i mbledhjeve në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik ose me numër të reduktuar të deputetëve të seancës plenare do të përcaktohet nga Konferenca e Kryetarëve.

- **Në lidhje me mënyrën e votimit në rastet e masave të jashtëzakonshme**

Në lidhje me mënyrën e votimit në rastet e masave të jashtëzakonshme është parashikuar se ai mund të kryhet edhe me mjete të komunikimit elektronik duke siguruar autentikimin/identifikimin e deputetëve. Rregullat e votimit do të përcaktohen nga Kryetari i Kuvendit për Konferencën e Kryetarëve, Byronë e Kuvendit dhe Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, ndërsa rregullat për zhvillimin e votimit në komisionet parlamentare dhe seancë plenare do të përcaktohen nga Konferenca e Kryetarëve.

Në rastet e masave të jashtëzakonshme, kur deputetët në seancë plenare do të jenë fizikisht, votimi do të zhvillohet sipas rregullave të përcaktuara nga Kryetari i Kuvendit.

- **Në lidhje me aplikimin e instrumentit “procedurë e përshpejtuar” në shqyrtimin e projektligjeve në kushtet e masave të jashtëzakonshme**

Aktualisht neni 28 i Rregullores parashikon shprehimisht se “”Kuvendi nuk mund të shqyrtojë më shumë se tri projektligje me procedurë të përshpejtuar në programin 9 javor të punës së Kuvendit dhe një projektligj në kalendarin 3 javor të punimeve të tij””.

Projektvendimi parashikon heqjen e kriterit numerik në aplikimin e kësaj procedure duke parashikuar se në rastet e masave të jashtëzakonshme, Kuvendi i Shqipërisë, me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të një të pestës së të gjithë numrit të deputetëve, mund të shqyrtojë me procedurë të përshpejtuar më shumë se një projektligj në kalendarin 3 javor dhe më shumë se tre projektligje në kalendarin 9 javor.

Kufizimet e përcaktuara nga neni 83, pika 3 e Kushtetutës dhe neni 28, pika 2 e Rregullores së Kuvendit nuk preken. Ky instrument nuk do të lejohet të përdoret në rastet e mëposhtme:

- për shqyrtimin e projektligjeve të parashikuara në nenin 81, paragrafi 2, me përjashtim të nënparagrafit “”dh””;
- për shqyrtimin e projektligjeve që synojnë përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian.

- **Në lidhje me zbatimin e rregullave procedurale të parashikuara në Rregulloren e Kuvendit në zhvillimin e mbledhjeve**

Në rastet e zhvillimit të mbledhjeve në distancë ose me numër të reduktuar të deputetëve me anë të mjeteve të komunikimit elektronik, parashikohet respektimi për aq sa mundet i rregullave procedurale të parashikuara në Rregulloren e Kuvendit.

- **Në lidhje me efektet e zbatimit të propozimeve**

Për ti dhënë vlefshmëri të gjitha mbledhjeve të zhvilluara deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi është përcaktuar se efektet e zbatimit të këtyre propozimeve të fillojnë më 15.03.2020, datë kjo që lidhet me hyrjen në fuqi të aktit normativ nr. 3 datë 15.03.2020 të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19” në të cilin përcaktohen masat që duhet të merren në kushtet e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”.

VI. PËRFUNDIM

Në përfundim, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, konstatoi se:

- Në aspektin ligjor, projektvendimi është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektvendimi është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

Përsa më sipër Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin pasi shqyrtoi projektvendimin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, sipas tekstit bashkëlidhur, i cili i përcillet për votim seancës plenare.

Kryetar

GRAMOZ RUÇI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

**PROJEKTVENDIM
“PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 166, DATË 16.12.2004 “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË SHQIPËRISË” TË
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 75, pika 2 të Kushtetutës dhe nenit 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Kryetarit të Kuvendit,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, "Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Pas nenit a/4 shtohen nenet a/5 , a/6 dhe a/7 me këtë përmbajtje:

Neni a/5

Mbledhjet në rastet e masave të jashtëzakonshme

Në raste të masave të jashtëzakonshme që mund të vendosen për shkak të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësive natyrore, mbledhjet e seancës plenare dhe organeve të Kuvendit mund të zhvillohen edhe në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik

Seanca plenare, mund të mblidhet edhe fizikisht me numër të reduktuar të deputetëve.

Kryetari i Kuvendit urdhëron zhvillimin e mbledhjeve në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik të Konferencës së Kryetarëve, Byrosë së Kuvendit dhe Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

Konferenca e Kryetarëve vendos zhvillimin e mbledhjeve në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik të komisioneve parlamentare si dhe zhvillimin e mbledhjeve në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik ose me numër të reduktuar të deputetëve të seancës plenare.

Në rastet e zhvillimit të mbledhjeve në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik, sipas parashikimeve të këtij neni, do të respektohen për aq sa mundet rregullat proceduriale të parashikuara në Rregullore.

Neni a/6

Votimi në rastet e masave të jashtëzakonshme

Në rastet e masave të jashtëzakonshme votimi mund të zhvillohet edhe me anë të mjeteve të komunikimit elektronik duke siguruar identifikimin e deputetëve sipas rregullave të përcaktuara nga Kryetari i Kuvendit për Konferencën e Kryetarëve, Byronë e Kuvendit dhe Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin dhe Konferenca e Kryetarëve për komisionet parlamentare dhe seancën plenare.

Në rastet e masave të jashtëzakonshme, kur në seancë plenare deputetët janë fizikisht, votimi zhvillohet sipas rregullave të përcaktuara nga Kryetari i Kuvendit.

Neni a/7

Procedura e përshpejtuar e shqyrtimit të projektligjeve në rastet e masave të jashtëzakonshme

Në rastet e masave të jashtëzakonshme, Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose një të pestës së të gjithë numrit të deputetëve, mund të shqyrtojë me procedurë të përshpejtuar më shumë se një projektligj në kalendarin 3 javor dhe më shumë se tre projektligje në kalendarin 9 javor.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet prej datës 11.03.2020.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI